

UDHËZIM
Nr. 6, datë 21.1.2025

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 22.7.2024
“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË PUNONJËSVE
ARSIMORË”

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 59, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024. “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 17, datë 22.7.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 1, e nenit 3, të kreut I ndryshon si më poshtë:

“1. Testimi i informatizuar do të zhvillohet nëpërmjet sistemit elektronik, Sistemit të Provimit të Shtetit”.

b) Shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 17, të kreut III ndryshon si më poshtë:

“a) Licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit, në profilin përkatës.

Mësuesit që janë përjashtuar nga detyrimi i provimit të shtetit, ngarkojnë diplomë në fushën e mësuesisë ose diploma të arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë ose të barasvlershme me to, të ngjashme ose të përafërta me fushën përkatëse të mësimdhënies në arsimin parauniversitar, përfshirë edhe diplomat e kandidatëve që japin lëndët e muzikës, të arteve pamore, kërcimit dhe edukimi fizik.

Mësuesit ngarkojnë edhe diplomën për fitimin e gradës shkencore “Doktor” në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës (nëse ka)”.

c) Shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1 dhe shkronjat “a” dhe “ç”, të pikës 2, të nenit 29, të kreut VI ndryshojnë si më poshtë:

“1. Për dosjen:

a) kandidati ka të drejtë të ankohet nëpërmjet portalit e-Albania, në formularin e shërbimit përkatës, brenda 3 (tri) ditëve nga bledhja në sistem e pikëve të vlerësimit të dokumentacionit nga Komisioni;

b) titullari i ZVAP-së shqyrton ankimin dhe ngarkon përgjigjen me nënshkrim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania brenda pesë ditëve nga data e ankimit. Në rast të pranimit të plotë ose të pjesshëm të ankimit, pikët e rivlerësuarahidhen në sistem nga titullari.

2. Për testimin e informatizuar:

a) kandidati ka të drejtë të ankohet në QSHA, nëpërmjet portalit e-Albania, lidhur me rezultatin e testimit të informatizuar, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e rezultatit të testimit të informatizuar;

...

ç) QSHA-ja i kthen përgjigje kandidatit mbi ankimin nëpërmjet portalin e-Albania, brenda 5 (pesë) ditëve pune.”

ç) Në nenin 33, pas paragrafit të parë, të kreut VII, shtohet paragrafi i dytë me përmbajtje si më poshtë:

“Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucionet kompetente, lidhur me procedurën e aplikimit për kualifikimin e punonjësit arsimor dhe/ose e ankimit, trajtoben dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre”.

d) Në shkronjën “a” të shtojcës nr. 5, togfjalëshi “... nuk mund t'i llogariten më shumë se 7 pikë në vlerësimin e dosjes” ndryshon në “...nuk mund t'i llogariten më shumë se 10 pikë në vlerësimin e dosjes”.

dh) Në shkronjën “b” të shtojcës nr. 5 bëhen ndryshimet si më poshtë:

“b) Diplomë: për ciklin e tretë studimeve “Master ekzekutiv” ose ekuivalentë me të në fushën e edukimit (nëse ka)”: 5 pikë.

Diplomë: për fitimin e gradës shkencore “Doktor” në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës (nëse ka)”: 10 pikë.”

Togfjalëshi në kolonën e pikëzimit që i përket shkronjës “b” ndryshon “nga 8-10 pikë” në “5-10 pikë”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit

Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Orjana Osmani